

# FTESË

## NË SESION INFORMUES PËR PUNËKËRKUES TË REGJISTRUAR NË ZYRAT E PUNËSIMIT NË MITROVICË JUGORE DHE SHTIME

Organizata “Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë së Kosovës” (IADK), është duke zbatuar projektin “Mbështetja në punësimin e të rinjve dhe grave në zonat rurale përmes zhvillimit të bujqësisë” projekt dyvjeçar (2020-2022), i përkrahur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë. Projekti përfshin komunat: **Mitrovicë e Jugut** dhe **Shtime**, të cilat janë bashkë-aplikuese dhe partnere të projektit.

**IADK do të organizojë sesion informues në Sallën e Kuvendit Komunal të Shtimes me datë 18 gusht 2021 nga ora 10:00** ku ndjekësit do të kenë mundësinë të marrin informata për projektin në fjalë.

Gjatë sesionit informues, të interesuarit do të njoftohen veçanërisht për komponentin e përkrahjes së **45 punëkërkuesve të regjistruar** në zyrat e punësimin në Mitrovicë Jugore dhe Shtime me trajnim në kursin “vetëpunësim” nga qendrat përkatëse për aftësim profesional; mbështetjen me grante bujqësore të **23 prej 45 punëkërkuesve të regjistruar** (4 përfitues të përzgjedhur nga thirrja e kaluar do të mbështeten nga kjo thirrje) me grante në vlerë **€3,000 euro (vetëpunësim)** dhe **€5,000 euro (start-up)**; dhe këshillimin e 27 përfituesve të granteve në aspektin teorik dhe praktik sipas sektorit të bujqësisë.

Për informata më të hollësishme në lidhje me projektin dhe sesionin informues, mund të na kontaktoni edhe përmes adresës elektronike: [argjend.gjinovci@iadc.org](mailto:argjend.gjinovci@iadc.org), [elion.gerguri@iadc.org](mailto:elion.gerguri@iadc.org) apo përmes numrave të telefonit: **044 240 106** dhe **049 973 204**

Sinqerisht,

Zenel Bunjaku  
Drejtor Ekzekutiv